

Analiza #8

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Kriteret Ekonomike të Kopenhagës Çfarë duhet të bëjë Kosova?

Qershor 2009

## Përmbajtja

1. HYRJE.....	3
2. KOSOVA NË RELACION ME BASHKIMIN EVROPIAN.....	4
3. KRITERET EKONOMIKE TË KOPENHAGËS .....	6
4. ZOTIMI I INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE EKONOMIKE .....	9
4.1 ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN .....	9
4.2 ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR SFIDAT E RAPORTIT TË PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR VITIN 2008.....	18
6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....	21
Tabela e Indeksit IÇK për 27 Vendet e BE-së dhe Vendeve të Ballkanit .....	26
Tabela e përqindjes (%) së Shkallës së Papunësisë për 27 Vende të BE-së dhe Vendeve të Ballkanit .....	28
Tabela Krahasuese për Rritjen Reale të GDP-së (%) në për vendet e BE 27 dhe të Ballkanit .....	30
Tabela e Krahasimit të Tregtisë së Jashtme për vendet e BE 27 dhe të Ballkanit .....	32

## 1. HYRJE

Për vendet në zhvillim, dhe sidomos për vendet në procesin e shtet-ndërtimit siç është Kosova, ekzistimi i një rruge të qartë për të ndjekur drejt zhvillimit të shtetit është lehtësues për shtetin dhe udhëheqësinë e tij. Për shtetet e Ballkanit Perëndimor, shtete në kategorinë e vendeve në zhvillim, integrimi në Bashkimin Evropian është bërë cak dhe motiv për ndërmarrjen e reformave të brendshme me qëllim të përmbushjes së kushteve që u mundësojnë të bëhen anëtarë të klubit të vendeve më të zhvilluara evropiane.

Bashkimi Evropian është një union politik dhe ekonomik i 27 vendeve evropiane, të cilat kanë krijuar strukturë institucionesh supranacionale me mundësinë e hapur që të gjitha vendet Evropiane të mund të anëtarësohen në të. Shtetet anëtare delegojnë një sërë kompetencash sovrane te Komisioni Evropian dhe te institucionet tjera supranacionale, të cilat kanë ekskluzivitet të ndërhyrjes në disa fusha, dhe në disa fusha të tjera kanë mundësi ndërhyrjeje në bashkëpunim me autoritetet e shteteve anëtare.

BE-ja shpesh përshkruhet si e ndarë në tri fusha të përgjegjësisë, të quajtura *shtylla*. Shtylla e parë përbën Politikën e Komunitetit Evropian, gjersa e dyta konsiston në Politikën e Përbashkët dhe të Sigurisë. Shtylla e tretë ka konsistuar në Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë, sidoqoftë me ndryshimet e prezantuara me Traktatin e Amsterdimit dhe të Nicës, aktualisht konsiston në Bashkëpunimin Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Kriminale. Thënë shkurt, shtylla e dytë dhe e tretë mund të përshkruhen si shtylla ndërqeveritare sepse institucionet supranacionale të Komisionit, Parlamentit, Gjykatës së Drejtësisë kanë rol të kufizuar ose s'kanë fare dhe udhëhiqen nëpërmjet Këshillit Ndërqeveritar të Ministrave të Këshillit Evropian. Shumica e aktiviteteve të BE-së burojnë nga shtylla e parë, shtylla e Komunitetit. Kjo është një shtyllë më e orientuar kah ekonomia dhe këtu institucionet supranacionale kanë ndikimin më të madh. Mirëpo, në mënyrë që një shtet të bëhet vend anëtar i Bashkimit Evropian, ai duhet të plotësojë një sërë kushtesh të paracaktuara. Anëtarësimi i një vendi në BE është procesi më i vështirë që vendi duhet të ndërmarrë për t'u anëtarësuar në një organizëm ndërkombëtar global apo rajonal, nga të gjitha organizmat ndërshtetëror ekzistues.

Në këtë analizë do të trajtojmë kriteret që nevojiten të plotësohen me qëllim të anëtarësimit në BE – me fokus kryesor në trajtimin e kriterëve ekonomike. Qëllimi i analizës është që të tregojë se çfarë ka nevojë të bëjë Kosova në mënyrë që të përmbushen Kriteret e Kopenhagës. Lista që e gjatë, analiza u bë e mërziqshme dhe perspektiva dukej minimale. Edhe përkundër 1502 masave të identifikuar në PVPE, analizat kanë treguar se akoma jemi larg përmbushjes së kriterëve. Kjo ka nxjerrë në pah probleme sistematike përbrenda sistemit të cilat mund të përmirësohen dhe sigurisht do të na çonin drejt rezultateve më të mira. Rëndësia e detyrave gjithashtu ka treguar se është koha që të largohemi nga klisheja e diskutimeve rreth Integritimit Evropian drejt diskutimeve për politika të vërteta dhe përpjekje të cilat do ta na çonin në drejtime të duhura.

Përderisa ekzistojnë probleme në marrëdhëniet zyrtare kontraktuale në mes BE-së dhe Kosovës, nuk ka arsye që të na ndalë drejt përmbushjes së kriterëve. Sidoqoftë, në marrim vlerësime vjetore nga Komisioni dhe përmbushja e standardeve do të na

ndihmonte në fushën e ekonomisë në përgjithësi. Qëllimi është ngritja e vetëdijes dhe të gjenden rrugë për përmirësimin e këtij procesi, hapjen e dialogut, përmirësimin e politikave, përmirësimin e cilësisë së jetës.

Nga të gjitha kriteret, ato ekonomike konsiderohen si kriteret më të vështira për tu përmbushur. Kërkojnë angazhim të madh, resurse dhe përpjekje të mëdha dhe marrin kohë të gjatë për t'u plotësuar.

## 2. KOSOVA NË RELACION ME BASHKIMIN EVROPIAN

Në takimin e Këshillit Evropian më 16 qershor 2003 në Selanik, që ndryshe njihet si Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor, vendet ballkanike u ftuan t'i bashkohen familjes evropiane duke ndjekur paraprakisht një proces sistematik të reformave. Në të thuhet se shtetet e Ballkanit do të jenë pjesë e Evropës së bashkuar, në çastin kur do të përmbushin kushtet që njihen si Kriteret e Kopenhagës.

Që nga viti 1999, Kosova ka pasë marrëdhënie të veçanta bashkëpunimi me Bashkimin Evropian. Kjo edhe për faktin se BE ka qenë dhe mbetet donatori më i madh për Kosovën, si dhe në anën tjetër, ndihmat e BE për Kosovën janë më të mëdha për kokë banori në krahasim me çdo vend tjetër. Me qëllim të garantimit dhe suksesit të kësaj ndihme, BE dhe Kosova kanë pasur marrëdhënie bilaterale të veçanta nga ato të me Serbinë dhe Malin e Zi që prej vitit 1999.

Në relacion me vendet që kanë shprehur synimin e tyre për anëtarësim në BE, Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshje Asociimi në shkëmbim të përkushtimeve për reforma politike, ekonomike, tregtare ose reforma në fushën e të drejtave të njeriut. Si shpërblim, vendeve u ofrohet qasje e lirë në disa ose në të gjitha tregjet e BE-së (të mirat industriale, prodhimet bujqësore, etj.) dhe ndihmë financiare ose asistencë teknike.

Në Nëntor 2000, Samiti i Zagrebit vuri vulën mbi **Procesin e Stabilizim Asociimit** duke fituar pajtimin e regjionit në themelimin e një kornize objektivash dhe kushtesh. Prosesi i Stabilizim Asociimit bazohet kryesisht në tri shtylla: 1. ofertën e stimujve atraktivë ekonomik dhe politik, duke përfshirë marrëdhënie më të afërt me BE-në, dhe në periudhë afatgjate, integrim në BE; 2. obligimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të ndërmarrë reforma gjithëpërfshirëse; dhe 3. theksimin e nevojës për bashkëpunim intensiv rajonal.

Siç është konfirmuar nga Samiti i Selanikut i Qershorit 2003, Kosova është futur në kornizën e Procesit të Stabilizim Asociimit. Më 20 Prill 2005, Komisioni Evropian paraqiti një Komunikatë mbi Kosovën të quajtur "*A European Future for Kosovo*" për të rifuoruar përkushtimin e Komisionit mbi Kosovën.

Deri më tani Kosova nuk ka marrëveshje kontraktuale me Bashkimin Evropian sikurse kanë vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Kjo do të zgjas deri në atë fazë kur Kosova të njihet nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Përkundër pamundësisë politike që Kosova të mund të hyjë në marrëveshje kontraktuale me BE-në, ajo duhet të përmbush kriteret e

përcaktuara. Por në Nëntor 2002, Komisioni Evropian ka filluar të ashtuquajturin **Mekanizëm Përcjellës të Stabilizim Asociimit (MPSA)**, si një proces për të promovuar dialogun politik në mes të BE-së dhe autoriteteve të Kosovës në çështjet e përafrimit. Ky mekanizëm do të sigurojë se Kosova nuk do të izolohej nga shtegu i tranzicionit për përafrimin e zhvillimit të Evropës Juglindore me BE-në.

Në Agjendën e Selanikut në Qershor të vitit 2003 u futën një varg instrumentesh të reja për të mbështetur procesin e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe t'i shpie ato më afër BE-së. Instrumenti me ndikim më të madh nga to është **Partneriteti Evropian**. Partneriteti Evropian synon t'i ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor në reformat dhe përgatitjet për anëtarësim në të ardhmen. Dokumenti i Partneritetit Evropian publikohet një herë në dy vjet, dhe në të renditen detyrat dhe prioritetet që duhen përbushur nga secili vend i rajonit, sipas afateve kohore të mirëpërcaktuara.

Vlerësimin i përbushjes së të gjitha obligacioneve që rrjedhin nga Partneriteti Evropian sigurohet nga **Raportet Vjetore të Progresit** të përpiluara nga Komisioni Evropian. Komisioni Evropian përpilon Raportet e Progresit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Komisioni Evropian raporton rregullisht te Këshilli dhe Parlamenti Evropian mbi progresin e arritur nga këto vende. Raportet analizojnë situatën politike të këtyre vendeve në fushën e demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut, mbrojtjes së pakicave dhe bashkëpunimi rajonal. Veç kësaj, këto raporte analizojnë situatën ekonomike, përbushjen e kriterëve sektoriale të njohura si standarde evropiane dhe përafrimi i legjislacionit vendor me atë të BE (*acquis communautaire*).

Më 17 Korrik 2006 Këshilli adoptoi Rregulloren (EC) Nr. 1085/2006, për të themeluar **Instrumentin e Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA)**, i cili ripërtërinë kornizën për asistencë financiare të vendeve para anëtarësimit. Instrumenti i Para-Anëtarësimit u ofron asistencë të racionalizuar vendeve aspirante për t'u integruar në BE për periudhën 2007-2013 mbi bazë të mësimave nga instrumentet e mëparshme të ndihmave të jashtme dhe instrumenteve të para-anëtarësimit (PHARE, ISPA, SAPARD, Instrumenti i Para-Anëtarësimit për Turqinë, Instrumenti i Para-Anëtarësimit për Ballkanin, CARDS). Qëllimi i IPA-s është të zhvillojë efikasitetin dhe koherencën e asistencës me mjete të një kornize të vetme.

Ekzistojnë pesë komponente nën të cilat bien projektet në kuadër të IPA:

1. Asistencë Tranzicioni dhe Ndërtim Institucionesh
2. Bashkëpunim Rajonal dhe Ndër-kufitar
3. Zhvillim Regjional
4. Zhvillim të Resurseve Njerëzore
5. Zhvillim Rural

Vendi ynë si kandidat potencial përfiton vetëm nga komponenta e parë dhe e dytë, kurse tri komponentat e fundit janë të destinuara për vendet potenciale candidate. Tabela në vijim pasqyron shumat e mjeteve që janë dhënë për vendet e Ballkanit Perëndimor veç e veç për periudhën 2008-2012.

Tab. 1. Asistenca Financiare e BE-së nën Instrumentin e Para-Anëtarësimit për vendet kandidatë potenciale

	2008	2009	2010	2011	2012	Total 2008-2012
Shqipëria	70.7	81.2	93.2	95.0	96.9	437.0
B&H	74.8	89.1	106.0	108.1	110.2	488.2
Mali i Zi	32.6	33.3	34.0	34.7	35.4	170.0
Serbia	190.9	194.8	198.7	202.7	206.8	993.9
<b>Kosova</b>	<b>184.7</b>	<b>106.1</b>	<b>67.3</b>	<b>68.7</b>	<b>70.0</b>	<b>496.8</b>
Total	553.7	504.5	499.2	509.2	519.3	2585.9

Në vitin 2008 Komisioni Evropian konfirmoi se do të bëjë një **studim fizibiliteti për Kosovën**. Rezultati i Studimit të fizibilitetit është përcaktues në hapat e mëtejshëm drejt nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mjeti që BE përdor për të ndihmuar përgatitjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

### 3. KRITERET EKONOMIKE TË KOPENHAGËS

Siç theksuam më sipër, secili vend evropian mund të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Por, anëtarësimi mund të arrihet vetëm nëse nga vendi plotësohen të gjitha kriteret e anëtarësimit, të njohura si *Kriteret e Kopenhagës*, kriteret të cilat janë vënë nga Këshilli Evropian në Kopenhagë më 1993. Kriteret e Kopenhagës ndahen në tri grupe kryesore: ato politike, ekonomike dhe në aftësinë e shteteve për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit, përfshirë këtu edhe ndjekjen e objektivave për një bashkim politik, ekonomik dhe monetar.

Kriteret ekonomike nënkuptojnë: një ekonomi funksionale tregu, si dhe aftësi për tu përballur me konkurrencën dhe fuqinë e tregut në BE. Sipas parimeve të Bashkimit Evropian, me ekonomi të tregut të lirë nënkuptohet:

- Vlerësim të përgjithshëm të procesit të tranzicionit, duke përfshirë procesin e privatizimit dhe ridefinimin e rolit të shtetit në ekonomi dhe në strukturat ekonomike;
- Liberalizimi i çmimeve dhe liberalizimi i jashtëm, që nënkupton heqjen e barrierave tregtare dhe kompletimi i procesit të konvertimit të monedhës kombëtare me euron;
- Vendosja e një sistemi të qëndrueshëm legal dhe infrastrukturë institucionale për garantimin e funksionimit të tregut të lirë, duke përfshirë rregullimin e të drejtave të pronësisë, heqjen e barrierave të ndryshme që pengojnë hyrjen në treg (hapjes së kompanive të reja) dhe daljes nga tregu (bankrotimet dhe likuiditetet), dhe konkurrencën e hapur;
- Stabilitet makroekonomik (stabilizimi i çmimeve, reduktimi i inflacionit, rritja e GDP, investimet e huaja direkte, tregtia e jashtme, qëndrueshmëri financiare, etj.);
- Konsensus të gjerë sa i përket vendosjes së parimeve dhe politikave ekonomike;
- Sektor financiar të zhvilluar mirë i cili orienton kursimet në drejtim të investimeve produktive.

Aftësia ekonomike që një shtet duhet të ketë me qëllim që të përballlet me fuqinë e konkurrencës dhe fuqinë tregtare brenda BE-së nënkupton përmbushjen e këtyre kushteve:

- Kornizë stabile makroekonomike, por duke lejuar agjentët ekonomikë të marrin vendime në një klimë parashikueshmërie;
- Masë të mjaftueshme të kapitalit fizik dhe njerëzor, me kosto të duhur, duke përfshirë infrastrukturën, sistemin arsimor dhe hulumtimet shkencore;
- Nivel zhvillimi në të cilin politikat qeveritare dhe legjislacioni në fuqi ndikojnë në aspektin e konkurrencës përmes politikave tregtare, politikave konkurruese, ndihmave shtetërore, mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, etj.;
- Pjesëmarrja në një masë të konsiderueshme e ndërmarrjeve të vogla në ekonomi, për shkak se ndërmarrjet e vogla janë të prirura të përfitojnë më shumë nga përmirësimi i kriterëve për hyrjen në treg, dhe pjesërisht për faktin se dominimi i ndërmarrjeve të mëdha mund të shfaq probleme në përshtatshmërinë e tyre me rregullat e reja;
- Një shkallë të caktuar të integritit tregtar të një vendi në relacion me BE-në para se ai të anëtarësohet në BE, dhe këtu përfshihen sasia dhe lloji i mallrave që tregtohen. Një ekonomi do të jetë më e aftë të përmbush obligimet e anëtarësisë në proporcion me atë se sa ka marrëdhënie ekonomiko-tregtare me vendet anëtare të BE;
- Ndërmarrjet publike nevojitet që të ristrukturohen dhe kompanitë duhet të investojnë në përmirësimin e efikasitetit. Për më tepër, sa më shumë që kompanitë kanë qasje në kapitalin e jashtëm dhe sa më të suksesshme që të jenë në aspektin e inovacionit dhe ristrukturimit, edhe mundësitë janë më të mëdha që të adaptojnë obligimet që dalin nga procesi i anëtarësimit;

Dokumenti i Partneritetit Evropian për çdo të dytin vit i qartëson objektivat cilat duhet të arrihen për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim, përfshirë edhe atë se cili duhet të jetë fokusi dyvjeçar i një vendi për përmbushjen e kriterëve ekonomike. **Partneriteti Evropian 2004 për Kosovën** kërkonte nga Kosova ndërmarrjen e këtyre masave me qëllim të përmbushjes së kriterëve ekonomike:

1. Definimi i prioriteteve makro-ekonomike për Kosovën në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në;
2. Rivitalizimi i procesit të privatizimit në atë mënyrë që të mbështes zhvillimin ekonomik të vendit dhe të tërheq investimet e brendshme dhe të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse për këtë qëllim;
3. Të zhvillohen sisteme të mbështetjes teknike dhe procedurave për siguruar transparencë, efikasitet dhe menaxhim më të mirë të shpenzimeve publike; dhe
4. Vendorsja e procedurave efektive për zbulimin, trajtimin dhe monitorimin e rasteve të dyshuara të mashtrimit dhe parregullsitë e tjera që ndikojnë në fondet vendore dhe ndërkombëtare.

Ndërsa, **Partneriteti Evropian për Kosovën i vitit 2006**, në fushën e ekonomisë kërkonte:

1. Finalizimin e procesit të privatizimit në përputhje me planin e AKM-së;
2. Finalizimi i inkorporimit të ndërmarrjeve publike, kryesisht shërbimi i energjisë, hekurudhat, ngrohja lokale dhe shërbimet e ujit e të mbeturinave. Implementimi



- i hapave të mëtejshëm të ristrukturimit të qeverisjes, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare. Fuqizimi i mëtejshëm i kornizës rregullative për shërbime publike dhe ngritja e kapaciteteve administrative të rregullatorëve të pavarur;
3. Fuqizimin e transparencës dhe qëndrueshmërisë së financave publike. Sigurimi i konsistencës së buxhetit 2006 me kornizën e konsoliduar të shpenzimeve afatmesme;
  4. Definimi dhe implementimi i prioriteteve makroekonomike dhe buxhetore në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në;
  5. Ngritja e disiplinës fiskale dhe kontrolli më i mirë i shpenzimeve publike. Themelimi i procedurave efektive për detektimin, trajtimin dhe përcjelljen e rasteve të mashtrimeve dhe parregullsive tjera që prekin fondet nacionale dhe ndërkombëtare;
  6. Vazhdimi i zhvillimit të një kornize legislative dhe politike për tregti dhe politika në lidhje me tregtinë, duke siguruar harmoninë me BE-në dhe OTB-në. Nxjerrjen dhe implementimin e ligjit mbi aktivitetet e jashtme tregtare;
  7. Përmirësimi i cilësisë së arsimit primar, sekondar, universitar dhe trajnimeve arsimore.

Dokumenti i fundit për **Partneritet Evropian për Kosovës është ai i shkurtit 2008**, ku sa i përket kriterëve ekonomike kërkohet që:

1. Të mbahen politika fiskale stabile dhe, në veçanti, të sigurohet që politikat sociale që adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social, të jenë në harmoni me qëndrueshmërinë afatgjate të financave publike;
2. Të caktohen synimet vjetore për inkasimin më efikas të shërbimeve publike, dhe definimi dhe zbatimi i strategjive për t'i arritur këto synime;
3. Të avancohet në mënyrë domethënëse privatizimi i ish-ndërmarrjeve shoqërore në pajtueshmëri me afatet e përcaktuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit;
4. Të përmirësohet qeverisja, efikasiteti dhe qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjeve publike. Të përforcohet më tutje pavarësia operuese dhe financiare e autoriteteve rregullative me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës në sektorët relevantë;
5. Të zhvillohen dhe zbatohen politikat që lehtësojnë transferimin nga punësimi i paregjistruar në atë të regjistruar në mënyrë që të krijohet një treg pune funksional dhe zyrtar dhe të qartësohet efikasiteti i politikave të tregut të punës.

Sic shihet edhe nga pikat më lartë, disa nga sygjerimet në Partneritetin Evropian janë përsëritur vazhdimisht që nga viti 2004. Një shembull i tillë është privatizimi. Përshpejtimi i procesit të privatizimit, rivitalizimi i procesit të privatizimit në mënyrë që të mbështes zhvillimin ekonomik dhe implementimi i planit të privatizimit kanë qenë kërkesat kryesore të Partneritetit Evropian përgjatë tri raporteve radhazi që nga 2004. Implementimi i politikave makroekonomike dhe definimi i tyre në koordinim me FMN-në gjithashtu kanë qenë kërkesa të përsëritshme të pasqyruara në Partneritetin Evropian.



#### 4. ZOTIMI I INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE EKONOMIKE

Institucionet qeverisëse të Kosovës, ekzekutivi dhe legjislativi i vendit, me qëllim të përmbushjes së të gjithë obligimeve që dalin nga procesi i anëtarësimit në UE, kanë përpiluar plane të veprimit për adresimin e çështjeve konkrete në plotësimin e Kriterëve të Kopenhagës dhe adresimin e sfidave që dalin nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian dhe Partneritetit Evropian të Kosovës. Dy planet kryesore të institucioneve vendore që momentalisht janë në fuqi janë: Plani i Veprimit për Partneritet Evropian dhe Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Pra ekzekutivi i vendit është i përkushtuar që të plotësoj kërkesat që dalin nga Partneriteti Evropian, kurse legjislativi si agjendë të tij në këtë drejtim ka zgjidhjen e sfidave që dalin nga Raporti i Progresit i 2008. Më poshtë do të shqyrtojmë veprimet që dalin nga këto dy plane sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike.

##### 4.1 ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN

Pas vendimit të Këshillit të Ministrave të UE të 18 shkurtit 2008 për Partneritetin Evropian për Kosovën, Qeveria e Kosovës filloi hartimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE), të cilin e miratoi në mbledhjen e 31 korrikut 2008. Sipas PVPE, Qeveria e Kosovës përgatit raport për ecurinë e implementimit të PVPE në muajt tetor dhe qershor. Deri më tani është përgatitur raport për periudhën tetor 2007 – qershor 2008, dhe për periudhën qershor-tetor 2008. Raporti për periudhën tetor 2008 – qershor 2009 është duke u hartuar dhe pritet të bëhet publik pas qershorit 2009. Nga 1502 sfidat që janë adresuar në PVPE, 50 prej tyre kanë të bëjnë me kriteret ekonomike. Nga këto 50 kriteret ekonomike të identifikuar në PVPE, shumica prej tyre kanë të bëjnë me përmirësim të legjislacionit dhe politikave fiskale. Më poshtë kemi listuar këto kriteret të cilat parashihen të zgjidhen me PVPE:

**1 Të mbahen politika fiskale stabile dhe, në veçanti, të sigurohet që politikat sociale që adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social, të jenë në harmoni me qëndrueshmërinë afatgjate të financave publike**

	<i>Hapat që ka identifikuar Qeveria për adresimin e këtij problemi</i>	<i>A është realizuar?</i>
1	Të rishikohet dhe azhurnohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH)	Qeveria e Kosovës për çdo vit azhurnon Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Në prill 2008 Qeveria ka miratuar KASH 2010-2012 dhe në qershor është diskutuar në Kuvendin e Kosovës. KASH 2010-2012 nuk paraqet një gjendje optimiste për zhvillimin ekonomik të Kosovës në tri vitet në vazhdim. KASH parashih rënie të rëmetancave për 7% për shkak të krizës globale; rritje ekonomike vetëm prej 3.0-4.0%; deficit buxhetor; ulje të investimeve kapitale për shkak të kërkesës së FMN që

		rezerva buxhetore të mbahet në 200 milion €; pagesa e kuotës për anëtarësim në FMN dhe BB në shumë prej 154 milion €, etj. KASH 2010-2012 është kritikuar nga deputetët e opozitës dhe pozitës.
2	Të hartohen dhe miratohen amendamentet për buxhetin e 2008 me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike	Ndryshimet janë bërë më 30 korrik 2008, një ditë para se ky PVPE të miratohej në Qeveri. Por vetëm ky hap nuk ka ndikuar që të zgjidhen problemet sa i përket qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike.
3	Të përmirësohet menaxhimi i shpenzimeve të zotuar	Shpenzimet e zotuar, sidomos për projektet kapitale, janë menaxhuar në mënyrë të dobët deri më tani duke bërë që çdo vit të ketë një shpenzim të ulët të mjeteve të destinuara për këtë qëllim. Një gjë e tillë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2008, vetëm se në tre mujorin e fundit janë bërë shpenzimet më të mëdha duke bërë që për tre muaj të shpenzohet një shumë e konsiderueshme e buxhetit të pa shpenzuar gjatë nëntë muajve.
4	Të miratohet Projektligji për buxhetin e 2009.	Projektligji dhe ligji për buxhetin miratohen për çdo vit që nga 2000. Futja e kësaj pike në plan të veprimit nuk është e arsyeshme dhe nuk është hap konkret në drejtim të zgjidhjes së problemeve të adresuara në Partneritetin Evropian për Kosovën.
5	Rishikimi i tërësishëm i politikave dhe legjislacionit fiskal, me mundësinë e ndryshimit për ti harmonizuar me acquis.	Gjatë vitit 2008, Kuvendi ka aprovuar këto ligje që kanë të bëjnë me legjislacionin fiskal: Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligji për financat e pushtetit lokal, Ligji për Bankën Qendrore, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Kosovës për 2008, Kodi Doganor dhe i akcizave i Kosovës, Ligji për ndryshimin e Ligjit për ATK dhe procedurat, Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Ligji për TVSh, Ligji për të ardhurat e korporatave, Ligji mbi tatimin në të ardhurat individuale, Ligji për buxhetin e Kosovës për 2009. Gjithashtu Qeveria ka përcjell për në Kuvend deri më tani edhe një ligj të ri për TVSh, i cili do të zëvendësoj ligjin e vjetër.

6	Të rishikohet legjislacioni mbi tatimin, në veçanti ai mbi akcizën dhe taksën doganore, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për Investime të Jashtme Direkte.	Sa i përket legjislacionit mbi tatimin dhe akcizën janë miratuar këto ligje: Kodi Doganor dhe i akcizave i Kosovës, Ligji për ndryshimin e Ligjit për ATK dhe procedurat, Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Ligji për TVSh, Ligji për të ardhurat e korporatave, Ligji mbi tatimin në të ardhurat individuale. Megjithatë, Investimet e Jashtme Direkte nuk kanë shënuar rritje edhe përkundër ndërmarrjes së këtyre ndryshimeve në legjislacion. Në Kosovë nuk janë realizuar Investime të Jashtme Direkte në atë shkallë që është proklamuar nga Qeveria.
7	Hartimi dhe miratimi i amendamenteve të Ligjit mbi Përgjegjësitë e Menaxhimit të Financave Publike nr.2003/2	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë është miratuar në mars 2008.
8	Të rishikohen përjashtimet nga tatimet dhe nga taksat importuese.	Kuvendi e ka kaluar Projektligjin për Tatimin në Vlerën e Shtuar. Ky draft i ri ndryshon nga Ligjet e gjertanishme për TVSh, për faktin se ligjet e gjertanishme rregullonin vetëm çështjen e normës tatimore. Projektligji aktual për TVSh parasheh që të përjashtohen nga tatimet librat, sendet që shërbejnë për përdorim nga organizatat fetare në Kosovë, etj. Gjithashtu, në draftin aktual që ndodhet në Kuvend lihet hapur që edhe lojërat e fatit të mos paguajnë tatime, kompanitë e sigurimeve, si dhe lihet hapur që ministri i MEF mund të vendos se kush mund të lirohet nga TVSh. Në një dëgjim publik të organizuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, drafti aktual i Projektligjit për TVSh është kritikuar për përmbajtjen e tij, edhe për faktin se në shumë pika nuk është në harmoni me rregullat e BE. Kjo pasi që pothuajse në të gjitha vendet anëtare të BE, ka disa shkallë tatimore kurse në Kosovë është vetëm një.
9	Të ngritën kapacitetet analitike të Departamenteve për Ekonomi dhe Financa dhe komunave për përgatitjen e buxhetit.	Përderisa vërehet një ngritje e kapaciteteve në kuadër të MEF, kjo gjë nuk ka ndodhur në departamentet e ekonomisë së ministrive e institucioneve tjera, e aq më pak në komuna. Komunitat përballen me probleme të shumta në këtë fushë.
10	Të ngritën aftësitë për planifikim strategjik në	Në komuna nuk vërehet ndonjë ngritje e

	MEF dhe komuna.	kapaciteteve sa i përket planifikimit strategjik financiar.
11	Vetëdijesimi i opinionit publik lidhur me rolin dhe rëndësinë e politikave fiskale, përmes rritjes së transparencës.	Kjo objektivë është vështirë për tu matur se sa është realizuar. Qytetarët shumë pak kanë njohuri sa i përket politikave fiskale.
12	Të analizohet niveli i shportës ushqimore dhe të krahasohet me shkallën e ndihmës sociale	Sipas dokumentit “Letra e Bardhë” i cili është duke u hartuar në Qeveri dhe ende nuk është bërë zyrtar, si dhe sipas planit të MPMS të paraqitur në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012, parashihet indeksimi me inflacionin i përfitimeve nga Skema e Ndhmës Sociale.
13	Të merret vendim nga Qeveria me qëllim të përshtatjes së shportës ushqimore familjare me shkallën e ndihmës sociale	Mirëpo, një gjë e tillë vështirë se mund të ndodhë ngase me KASH 2010-2012 tërhiqet vërejtja se indeksimi me inflacionin i përfitimeve nga Skema e Ndhmës Sociale, së bashku me indeksimin e pensioneve, do të rris për 20 milion € koston buxhetore. Kosto e cila nuk do të mund të përballohet, sipas KASH.
14	Të identifikohen kategoritë të cilat nuk janë përfshirë në skemat ekzistuese	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale është miratuar në Qeveri në prill 2009. Ky ligj i identifikon disa kategori të reja që duhet të përfshihen në ndihmat sociale. Këto kategori janë: familjet të cilat do të kenë të drejtën e kyçjes në ndihmat sociale si pasojë e riklasifikimit të tokës, disa familje do të kyçen në këtë skemë si pasojë e uljes së shkallës së paaftësisë nga 80% sa ka qenë deri më tani në 60%; familjet në hasmëri, familjet që kanë mbetur nën përkujdesje të femrave dhe që jetojnë në vendbanime të thella malore në brezin kufitar, familjet që kanë anëtarë të narkoman apo të trafikuar, familjet që janë të marginalizuara dhe që nuk janë të integruara në arsimin, punësim dhe shërbime të tjera publike.
15	Të përgatitet analiza gjithëpërfshirëse për të shikuar nevojat për ndryshime në aspektin legjislativ dhe financiar (analizat e vlerësimit të nevojave) me qëllim të përfshirjes së kategorive të identifikuar.	Kategoritë e reja janë identifikuar por vështirë se do të mund të përfitojnë pasi që MEF ka kundërshtuar ndryshimet në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale, për shkak se do të rritet kostoja buxhetore për 3.3 milion € (nga 27.3 sa është tani në 30.6

		milion € pas ndryshimeve).
16	Të merret vendim për ti ndryshuar politikat sociale dhe fiskale me qëllim të inkuadrimin të kategorive të identifikuara.	Shiko më sipër.
17	Miratimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara	Një ligj i këtillë është miratuar më 16 maj 2008.
2	<b>Të caktohen synimet vjetore për inkasimin me efikas të shërbimeve publike, dhe definimi dhe zbatimi i strategjive për t'i arritur këto synime</b>	
	<i>Hapat që ka identifikuar Qeveria për adresimin e këtij problemi</i>	<i>A është realizuar?</i>
18	Të azhurnohen planet e biznesit të ndërmarrjeve publike me qëllim të përmbajtjes ndaj synimeve vjetore për inkasim më efikas	Ndërmarrjet Publike ende përballen me problemin e inkasimit. Një përmirësim vërehet tek inkasimi i KEK, ku sipas raporteve të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave gjatë vitit 2008 vërehet një rritje e inkasimit prej 18.26% në krahasim me vitin 2007.
19	Hartimi i planit për ti arritur këto synime	Sa i përket planeve të NP-ve për rritjen e inkasimit të të hyrave, deri më tani është bërë i ditur vetëm plani i KEK-ut për rritjen e të hyrave. Sipas MEM-it, Bordi i Drejtorëve i KEK e ka aprovuar një skemë të re të inkasimit e cila së pari është provuar në Distriktin e Ferizajt. Sipas kësaj skeme, një ekip është caktuar për secilën dalje prej 10KV dhe ky ekip është përgjegjës të llogarisë të gjithë energjinë e furnizuar në atë dalje, te lexoj njehsorët, të lëshoj faturat dhe të kryej shkyçjet.
20	Organizimi i fushatave të vetëdijesimit për inkasimin e faturave	Ndërmarrjet Publike kanë shpenzuar me mijëra euro për të vetëdijesuar qytetarët për pagesën e faturave (të rrymës, ujit, bërllokut). Për të ilustruar këtë, Ministria e Energjisë dhe Minierave, sipas KASH, për tri vitet në vazhdim do të shpenzoj nga 100.000 € në vit për fushata vetëdijesimi. Për vitet 2009-2012 për këtë qëllim do të shpenzohen 450.000 €.
3.	<b>Të avancohet në mënyrë domethënëse privatizimi i ish-ndërmarrjeve shoqërore në pajtueshmëri me afatet e përcaktuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit</b>	
	<i>Hapat që ka identifikuar Qeveria për adresimin e këtij problemi</i>	<i>A është realizuar?</i>

21	Të rishikohet orari i AKM-së për privatizim me qëllim të përshpejtimin të procesit të privatizimit	Nga janari 2008 e deri më shkurt 2009, janë privatizuar 20 ndërmarrje publike. E që është një numër i vogël në krahasim me periudhat e mëhershme. Pas ndërrimit të statusit nga AKM në AKP, janë anuluar tri valë të privatizimit duke bërë që të vonohet procesi i privatizimit për valët 31, 32 dhe 33.
22	Hartimi i planit të veprimit për të avancuar procesin e privatizimit	AKP tani ka shpallur valën e 34 të privatizimit, si dhe Bordi i Drejtorëve të AKP ka aprovuar edhe valën e 35 dhe 36 të privatizimit. Mirëpo, gjatë këtyre viteve të privatizimit, ky proces nuk ka ndikuar në rritjen ekonomike.
4.	<b>Të përmirësohet qeverisja, efikasiteti dhe qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjeve publike. Te përforcohet më tutje pavarësia operuese dhe financiare e autoriteteve rregullative me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës në sektorët relevantë</b>	
	<i>Hapat që ka identifikuar Qeveria për adresimin e këtij problemi</i>	<i>A është realizuar?</i>
23	Ngritja e kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.	Nuk është e ditur se sa është duke u bërë në këtë drejtim, mirëpo në realitet nuk ka ndonjë rezultat të dukshëm sa i përket menaxhimit financiar të ndërmarrjeve publike.
24	Të miratohet projektligji për miniera dhe minerale që do të zëvendësoj Rregulloren e UNMIK-ut nr.2005/2 dhe 2005/3	Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë është miratuar më 13 qershor 2008, para miratimit të PVPE. Ky ligj nuk e zëvendëson rregulloren e UNMIK-ut vetëm se e ndryshon. Kurse ligji për zëvendësimin e Rregullores 2005/3 ende nuk është miratuar.
25	Të vazhdohet me studimin gjeokimik në vitin 2008 dhe 2009 për të kompletuar njërin nga komponentët e të dhënave teknike që përdoren për të tërhequr investitorë në sektorin e mineraleve të Kosovës.	Nuk ka ende asgjë konkrete në këtë drejtim.
26	Marrja përsipër e një Studimi Infra të Kuq të Reflektimit të Spektroskopisë.	Kjo ende nuk ka filluar dhe nuk ka ndonjë plan se kur do të filloj.
27	Të bëhen përgatitjet e nevojshme (ligjore dhe financiare) për të bërë studim Gjeologjik të Kosovës	Kjo ende nuk ka filluar.

28	Të bëhen përgatitjet për diskutim të mirëfilltë nga Qeveria e Kosovës mbi Raportin e Misionit Vlerësues të Komisionit Evropian për Rregullatorët në Kosovë me qëllim që të ndërmerren masat e nevojshme për sigurimin e pavarësisë operuese dhe financiare të rregullatorëve.	Rregullatorët përballen me probleme të natyrave të ndryshme. Si për shembull, Bordi i Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit operon me mandat të skaduar që nga dhjetori 2008 dhe Kuvendi i Kosovës nuk merr mundin që të zgjidh një bord të ri. Ende nuk është zgjedhur drejtori dhe zëvendësdrejtori i Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe mbeturina, etj.
29	Të krijohet një Autoritet Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës, me pavarësi operacionale dhe financiare.	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ende nuk është funksionalizuar. Parashihet me planet e MTPT të paraqitura në KASH 2010-2012.
30	Miratimi i Ligjit mbi Aviacionin.	Ligji për Aviacionin Civil është miratuar më 13 mars 2008.
31	Krijimi i një autoriteti të pavarur të aviacionit civil.	Është formuar konform Ligjit për Aviacionin Civil.
32	Mbajtja e taksës ekzistuese të udhëtarëve përmes një instrumenti të përshtatshëm ligjor sipas Ligjit të ri mbi Aviacionin Civil për të mundësuar vetë-financimin e ARAC-it në Kosovë.	Me 1 janar 2009 ka hyrë në fuqi Rregullorja 2008/7 mbi tarifën e sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova, e nënshkruar nga Ministri i Transportit dhe Poste-Telekomunikacionit. Fondet e mbledhura nga kjo tarife (2€ për udhëtar) shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve operacionale të Autoritetit të Aviacionit Civil. Një tarife e njëjtë prej 2€ ka ekzistuar edhe për financimin e ish-Zyrës Rregulatore të Aviacionit Civil, përmes Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2006/2.
33	Miratimi i një skeme të përshtatshme të taksave dhe pagesave për licencim, certifikim dhe aktivitete mbikëqyrëse të kryera nga ARAC (CARO).	Rregullorja për këtë qëllim nuk është nxjerr ende. Është hartuar një draft i cili duhet të miratohet nga Ministria e Transportit apo nga Qeveria.
34	Themelimi i Bordit Mbikëqyrës jo-ekzekutiv për ARAC-në për të mundësuar pavarësinë operacionale të ARAC-së.	Ende nuk është themeluar ky bord.
35	Implementimi i plotë i Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe Ligjit të KE-së mbi Aviacionin.	Të gjitha instrumentet e nevojshme ligjore të parashikuara në fazën e parë implementuese të Marrëveshjes ECAA janë duke u implementuar në Kosovë.
36	Të analizohen dhe të identifikohen kundërthëniet e mundshme në mes të Ligjit	Pas aprovimit të PVPE nuk janë ndryshuar këto ligje.



	mbi Telekomunikacionin dhe Ligjit mbi Financat Publike.	
37	Hartimi dhe miratimi i amendamenteve të Ligjit mbi Telekomunikacionin.	Ende nuk është miratuar një ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për telekomunikacionin. Një gjë e tillë parashihet me Strategjinë Legjislative të Qeverisë, ku ky projektligj pritet të miratohet në tetor 2009.
38	Transferimi i Zyrës për Menaxhimin e Frekuencave (ZMF-së) në ART.	ZMF ka qenë kompetencë e rezervuar e PSSP dhe tani ka kaluar në kuadër të ART-së.
39	Harmonizimi i tabelës së ndarjes të frekuencave në përputhje me tabelën Evropiane të rëndomtë të ndarjes dhe me Vendimin Nr.676/2002/EC.	Nuk është realizuar ende dhe sipas ART kjo pikë pritet të përmbushet në tre mujorin e katërt të këtij viti.
40	Krijimi i rregullores për tarifat e spektrit.	Është miratuar rregullorja.
41	Sigurimi i veglave elektronike (softuer i avancuar për menaxhimin e spektrit të frekuencave).	Këto vegla janë siguruar.
42	Krijimi i stacionit fiks për monitorimin e spektrit. Ngritja e kapaciteteve për të kryer monitorimin e spektrit dhe matjen nga distanca të parametrave të emetimit, mbajtja e spektrit, identifikimi i emetimeve dhe lokacioni i burimit të ndërhyrjes së dëmshme.	Nuk është realizuar ende. Pritet të realizohet gjatë vitit 2010.
43	Miratimi i Projektligjit mbi Zyrën e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM-in).	Një projektligj i tillë ende nuk është miratuar.
44	Të përgatiten dhe botohen raportet Vjetore të Performancës mbi performancën operationale dhe atë financiare të furnizuesve të shërbimit të ujit dhe të mbeturinave.	Raportet Vjetore të Performancës për vitet 2006 dhe 2007 janë publikuar në faqen zyrtare të ZRRUM, por jo edhe ai i vitit 2008.
45	MEF të koordinojë opsionet me ZRRUM-in për të siguruar pavarësi financiare.	Në Raportin vjetor të ZRRUM për 2008, ky rregullator ankohet në Qeverinë për pengimin e qëndrueshmërisë financiare të saj. Sipas ZRRUM edhe pse ky rregullator mund të ketë financim të qëndrueshëm nga të hyrat e licencave, kjo nuk është e mundur ngase ZRRUM klasifikohet si të gjitha organizatat e tjera buxhetore dhe kjo sipas tyre paraqet problem për qëndrueshmërinë financiare. Për të ngritur qëndrueshmërinë financiare të ZRRUM, kjo e fundit ka rritur tarifat

		nga 1 janari 2009 me arsyetimin për të mbuluar kostot e kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave.
46	Të ngritën kapacitetet e rregullatorëve.	Nuk ka ndonjë raport se sa është realizuar ky qëllim.
47	Sigurimi i mëvetësisë financiare të ZRRE-së duke i respektuar dispozitat ligjore sa i përket buxhetit të ZRRE-së	Në mars të 2009 Qeveria ka dërguar në Kuvendin e Kosovës Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Rregullatorit të Energjisë. Ky ligj është refuzuar nga Kuvendi i Kosovës ngase me ndryshimet e parapara nga ana e Qeverisë synohej që ti merreshin disa kompetenca ZRrE-së dhe ti jepeshin MEM-t, siç janë shpallja dhe menaxhimi i tenderëve, ndërtimi i kapaciteteve të reja, etj. Ndonjë ndryshim tjetër për këtë qëllim nuk është marë.
5.	<b>Të zhvillohen dhe zbatohen politikat që lehtësojnë transferimin nga punësimi i peregjistruar në atë të regjistruar në mënyrë që të krijohet një treg pune funksional dhe zyrtar dhe të qartësohet efikasiteti i politikave të tregut të punës</b>	
	<i>Hapat që ka identifikuar Qeveria për adresimin e këtij problemi</i>	<i>A është realizuar?</i>
48	Të bëhen politika dhe të nxirren rekomandime që ndihmojnë në lehtësimin e transferimit të punësimit të peregjistruar në atë të regjistruar.	Të papunët në Kosovë vetëm një përqindje e vogël e tyre regjistrohen në Entet e Punësimit. Kjo ndodh për faktin se regjistrimi në Entet e Punësimit nuk ka sjellë ndonjë përfitim deri më tani, andaj edhe nuk i besohet një procesi të tillë. Si pasojë e kësaj, nuk dihen shifrat e sakta të të papunëve në Kosovë.
49	Nxjerrja e politikave dhe rekomandimeve të cilat ndihmojnë lehtësimin e transferimit të punësimit të peregjistruar në atë të regjistruar.	MPMS nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim.
50	Identifikimi i institucioneve përgjegjëse për implementimin e politikave dhe rekomandimeve të dala nga analiza e tregut jo-formal të punës.	MPMS nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Në këtë fushë ende nuk janë miratuar ligjet bazë që rregullojnë çështjet e marrëdhënieve të punës.

## 4.2 ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR SFIDAT E RAPORTIT TË PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR VITIN 2008

Pas publikimit të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën në nëntor të 2008, Kuvendi i Kosovës, respektivisht Komisioni për Integritet Evropian, hartoi një plan të veprimit për zgjidhjen e sfidave të cekura në Raportin e Progresit. Kërkesa për një plan të tillë veprimi erdhi nga seanca e 11 dhjetorit 2008, kur Kuvendi i Kosovës ngarkoi Komisionin për Integritet Evropian që të hartoj një plan veprimi, kërkoi nga të gjitha komisionet parlamentare që të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij plani të veprimit dhe kërkoi nga Komisioni për Integritet Evropian që të raportoj në Kuvend pas çdo tre mujori për zbatimin e planit.

Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës, së bashku me Rezolutën për Prioritetet dhe Strategjitë e Kosovës për Integritet në Bashkimin Evropian, u miratua në seancën plenare të 26 shkurtit 2009. Në këtë plan të veprimit u identifikuan 110 sfida të cilat duhet të adresohen nga komisionet e caktuara të Kuvendit të Kosovës.

Nga 110 sfidat e identifikuar në Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, 8 prej tyre kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve ekonomike. Më poshtë janë të paraqitura vetëm pikat e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës që kanë të bëjnë me kriteret ekonomike:

Pika në Planin e Veprimit	Sfida në Raportin e Progresit 2008	Realizueshmëria
P58	Në përgjithësi, buxheti nuk është instrument efikas i politikës fiskale dhe nuk kontribuon në parashikueshmërinë e zhvillimeve ekonomike. Përkundrazi, buxheti i përgjigjet presioneve shpenzuese ad-hoc.	Për këtë qëllim, Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se në bazë të Raportit të tre mujor të Shpenzimeve për Buxhetin 2009, vërehet një performancë e mirë e të hyrave dhe shpenzimeve nga ajo që është planifikuar dhe realizuar. Gjithashtu, po ky komision raporton se gjatë shqyrtimit të KASH 2010-2012, vërehen projeksione të matura dhe kriza globale nuk ka ndikuar në këto projeksione. Realisht e kundërta është e vërtetë. Vetë KASH 2010-2012 e pranon se për shkak të krizës globale pritet një ulje prej 7% e reminetancave si dhe një rritje vjetore prej vetëm 3.0-4.0%. KASH 2010-2012 është kritikuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për mënyrën e hartimit dhe gjuhën e

		përdorur.
<b>P64</b>	Është shënuar një progres i kufizuar sa i përket lirisë së ofrimit të shërbimeve. Korniza ligjore për lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe e drejta e themelimit të ndërmarrjeve është ende fragmentare. Harmonizimi me standardet evropiane është shumë i kufizuar.	Nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim.
<b>P65</b>	Nuk mund të raportohet për ndonjë zhvillim në fushën e ligjit për ndërmarrjet	Ligji për ndërmarrjet publike është miratuar në procedurë të përsheptuar gjatë vitit 2008, si pjesë e ligjeve të Pakos së Ahtisaarit. Qeveria gjithashtu ka nxjerrë edhe Udhëzimin Administrativ për përbërjen e Bordeve të NP që ofrojnë shërbime për dy apo më shumë komuna. Në dhjetor 2008 Qeveria e Kosovës ka përzgjedhur anëtarët e 15 bordeve të ndërmarrjeve publike. Për ti ndryshuar tetë prej tyre në prill pas kritikave të ICO se emërimet ishin joprofesionale dhe politike.
<b>P66</b>	Nuk është shënuar asnjë progres sa i përket legjislacionit për shpëlarjen e parasë. Në përgjithësi, institucionet themelore që janë përgjegjëse për ndalimin e shpëlarjes së parasë bashkëpunojnë më njëri tjetrin. Qeveria ka iniciuar një plan veprimi për të luftuar shpëlarjen e parave. Mirëpo, mungesa e ekspertizës së gjyqësorit dhe forcave të rendit në hetimin e dhe gjykimin e krimeve komplekse ekonomike mbetet ende problematike. Zyra e prokurorit special të Kosovës ka ende mungesë të prokurorëve vendor dhe të prokurorëve specializuar. Lufta kundër shpëlarjes së parasë mbetet ende një sfidë.	Nuk ka ende asgjë konkrete në këtë drejtim. Sipas Strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës për 2009, Projektligji për shpëlarjen e parave parashihet që të miratohet në Qeveri në qershor 2009.
<b>P67</b>	Kapacitetet e ATK-së mbesin ende të dobëta. Sistemi i sajë i menaxhimit të informatave nuk	Kjo kërkesë e Raportit të Progresit 2008 është e njëjtë edhe me kërkesën e paraqitur në Partneritetin Evropian

është ende funksional. Duhet ende shume angazhime për të përmirësuar shërbimet për tatim paguesit. Legjislacioni mbi tatimin i Kosovës vetëm pjesërisht është në harmoni me standardet evropiane. Një harmonizim i mëtutjeshëm është i nevojshëm si dhe kërkohet një angazhim më serioz që të sigurohet një zbatim më efektiv i ligjit. Mbledhja e tatimit mbetet ende shumë e dobët dhe ekonomia joformale është shumë e shprehur pasi që kontrollimet janë të kufizuara.

për Kosovën 2008.

Në ATK nuk ka ndonjë rritje të kapaciteteve në këtë drejtim.

Qeveria ka miratuar Projektligjin për TVSh, Projektligjin për tatimin mbi të ardhurat individuale, etj. dhe këto projektligje tani ndodhen në Kuvendin e Kosovës. Por ashtu siç e thamë edhe në tabelën e PVPE, Projektligji për TVSh ka mangësi të mëdha dhe nuk pritet të miratohet së shpejti në Kuvend.

Në mars të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që deri më 1 korrik 2009 të vendosen pjesërisht arkat fiskale. Për këtë qëllim ATK ka filluar sensibilizimin e opinionit për nevojën e vendosjes së arkave fiskale, mirëpo në praktikë ende nuk ka asgjë konkrete. Qeveria ka vendosur që arkat fiskale ti vendos në mënyrë të pjesërishme dhe jo detyrimit për tërë territorin e Kosovës. Në të gjitha vendet e rajonit arkat fiskale janë vendosur njëkohësisht në tërë territorin dhe jo në mënyrë selektive. Vetëm vendosja e arkave fiskale nuk do të mund të luftoj ekonominë joformale. Mos kontrollimi i një pjese të territorit të Kosovës dhe menaxhimi joadekuat i kufijve ndikojnë në rritjen e ekonomisë joformale.

**P68** Komisioni për Konkurrencë (KK) ende nuk është funksional. Kuvende ende duhet të i emëroj kandidatët e përzgjedhur për komision. Kosova duhet të përfundoj me themelimin e KK-së përfshirë këtu edhe ndarjen e mjeteve financiare për të. Ligji mbi ndihmat e shtetit qëllimi i së cilit është themelimi i Zyrës për Ndihmat e Shtetit brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ende nuk është miratuar.

Kuvendi ka emëruar anëtarët e këtij komisioni, mirëpo ky komision ende nuk është funksional.

<b>P69</b>	Ligji mbi Prokurimin Publik (LPP që është amendamentuar në vitin 2007) është legjislacioni kryesor në këtë fushë. Në përgjithësi është në harmoni me standardet evropiane mirëpo, një numër i neneve të direktivave të miratuara në vitin 2004 nuk janë zbatuar. E njëjtë gjë vlen edhe për një regjim më fleksibil të shkruar për sektorin e shërbimeve komunale. Janë raportuar diskrepancat ndërmjet versioneve të ndryshme gjuhësore të këtij legjislacioni gjë që duhet të përmirësohen për të siguruar një saktësi më të madhe ligjore.	Qeveria e Kosovës është duke e ndryshuar përsëri Ligjin mbi Prokurimin Publik, por duke ndryshuar vetëm dispozitat e kërkuara nga Ministria e Punëve të Jashtme për ta lehtësuar procesin e prokurimit të Ambasadave të Kosovës.
<b>P70</b>	Trajnimi dhe certifikimi i zyrtarëve të prokurimit me autoritetin kontraktues është ndalur për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Institutit Kosovar për Administratë publike dhe KRPP.	Nuk ka pasur ndonjë përmirësim dhe kjo vazhdon të mbetet një problem i komunikimit në mes Institucioneve Qeveritare.

Komisioni për Integritim Evropian ende nuk ka paraqitur raport para Kuvendit të Kosovës mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës, edhe pse sipas planit raportet parashihen çdo tre muaj. Shumë pika të raportit që kanë qenë paraparë të zbatohen gjatë tre muajorit të parë nuk janë zbatuar, si dhe shumë pika të parapara për tu zbatuar në tre muajorit e dytë janë shtyrë për pjesën tjetër të vitit. Kësaj i ka kontribuar edhe mos përgjegjshmëria e ekzekutivit për t'iu përgjigjur kërkesave të komisioneve, si dhe mos gatishmëria e disa prej komisioneve parlamentare për të adresuar sfidat që u janë ngarkuar në bazë të Planit të Veprimit.

## 6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Kosova ka ende shumë për të bërë para se t'i qaset seriozisht përmbushjes së kriterëve ekonomike të Integritimit Evropian. Për çdo vit, Komisioni Evropian raporton për progresin e arritur për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor drejt Integritimit Evropian. Raporti i fundit i KE për vitin 2008 raporton shumë pak progres në përmbushjen e kriterëve ekonomike.

Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian shërben për të sqaruar Kriteret e Kopenhagës të cilat shërbejnë për përmirësimin e gjendjes. Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet që të shqyrtojë raportin e progresit dhe të ndërmarrë masa bazuar në komentet e raportit të progresit dhe më pas të analizojë veprimet në mënyrë që të ketë progres nga raporti në raport.

Siç mund të shohim nga të dhënat mësipërme, Agjensioni për Integritet Evropian po koncentrohet në PVPE e publikuar vitin e kaluar. Komisioni Parlamentar në anën tjetër, po koncentrohet në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian 2008 dhe ka përgatitur një plan veprimi për të adresuar sfidat e paraqitura në Raportin e Progresit.

Edhe pse Kosova nuk ka një marrëveshje zyrtare kontraktuale me BE, asgjë nuk mund ta ndalojë Kosovën në përmbushjen e kriterëve ekonomike drejt integritet. Këto kritere paraqesin problemet më të mëdha që Kosova ka në përgjithësi dhe përmbushja e kriterëve do të përmirësonte dukshëm potencialin që Kosova e ka drejt zhvillimit ekonomik.

Në përgjithësi, hulumtimet e bëra për këtë raport tregojnë se ka mjaft të dhëna në Kosovë rreth hapave që duhet ndërmarrë për t'iu afruar përmbushjes së kriterëve dhe të sqarohet në përgjithësi më tepër procesi i reformimit. Megjithatë, ne kemi hasur në disa sfida.

*Lidhja në mes të Politikave dhe Kriterëve është e dobët, si në analiza ashtu edhe në ndikim*

Akoma nuk ka një lidhje të qartë në mes të masave që autoritetet po përpiqen të arrijnë përmes PVPE dhe kërkesave të parapara nga kriteret. Kjo është përmendur gjithashtu në raportin e progresit 2008. Edhe pse është shënuar progres në disa fusha, nuk ka ndonjë plan pasues për ta analizuar ndikimin e masave specifike të përfunduara për përmbushjen e Kriterëve të Kopenhagës. Më poshtë, do të paraqesim disa shembuj ku besojmë se monitorimi duhet të jetë absolutisht i nevojshëm.

- Fusha e parë në Planin e Veprimit të Qeverisë bazuar në PVPE është që "të mbahen politika fiskale stabile dhe, në veçanti, të sigurohet që politikat sociale që adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social, të jenë në harmoni me qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike." Tjetër kërkesë është edhe azhurnimi dhe miratimi i KASH. Përderisa KASH është një mjet i rëndësishëm për të siguruar një planifikim afatgjatë të qeverisë, azhurnimi dhe miratimi i tij nuk garanton edhe afrimin drejt kriterëve. KASH-i i këtij viti tregon se politikat sociale në të vërtetë paraqesin një rrezik për qëndrueshmëri fiskale afatgjatë. Në Raportin e Progresit 2008, Kosova është kritikuar për jo-konsistencë dhe politika të paqëndrueshme në KASH. Analiza afatmesme e buxhetit ka devijuar nga KASH. Nuk ka pasur asnjë analizë të KASH që do të kishte përmirësuar këtë situatë.
- Miratimi i Buxhetit për 2009 është një procedurë e domosdoshme legislative. Miratimi i buxhetit nuk siguron qëndrueshmëri fiskale dhe stabilitet makroekonomik që kërkohet me kritere. Kjo është theksuar në raportin e progresit. Prandaj, është befasi të shihet kjo si plan veprimi në PVPE.
- Kosova vazhdimisht është kritikuar për mos zbatim të buxhetit veçanërisht sa i përket shpenzimeve kapitale. Përderisa Qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e shpenzimeve kapitale, shumë pak analiza janë bërë që të shihen se si masat e ndërmarra e kanë përmirësuar procesin. Kjo është diçka që lehtë mund të krijohet.
- Një nga kërkesat e përsëritura pa pushim është privatizimi. Çështja e privatizimit është përmendur në të gjitha raportet e Partneritetit Evropian që nga viti 2004.



- Një nga qëllimet bazë të privatizimit është rritja e efektshmërisë së ndërmarrjeve duke i transferuar ato në menaxhim të sektorit privat. Përmes kësaj synohet rritja e prodhimit, menaxhim më efikas, produktivitet më të lartë, si dhe burime më shume për qeverinë për t'u marrë me çështje tjera qeverisëse. Deri më tani, në Kosovë janë zhvilluar 34 valë privatizuese. Privatizimi në Kosovë ka nënkuptuar transferim të pronësisë në pronësi private. Privatizimi nuk ka ndikuar në uljen e papunësisë dhe rritjen e zhvillimit. Shumë ndërmarrje të privatizuara nuk janë aktivizuar asnjëherë, disa prej tyre janë ritenderuar për shkak të mos zotimeve të mbajtura nga ana e blerësve, etj. Masat e ndërmarrja nga Qeveria nuk kanë ndikuar në lehtësimin e procesit.
- Një nga rekomandimet e Partneritetit Evropian për Kosovën ishte rekomandimi që të sigurohet që politikat sociale që adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social janë në harmoni me qëndrueshmërinë afatgjate fiskale të vendit. Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për rritjen e rrogave të arsimtarëve. Në vitin 2009, qeveria ka marrë vendim për rritjen e rrogave të shërbyesve civil për 10% dhe ngritjen e pensioneve dhe ndihmës sociale për 5 euro. Kjo ka rënduar buxhetin e Kosovës edhe më shumë duke rrezikuar qëndrueshmërinë financiare. Sipas KASH 2010 – 2012 thuhet se për tri vitet në vazhdim është me rrezik rritja e pagave të shërbyesve civil. Sipas “Letrës së Bardhë” të Qeverisë rreth politikave sociale, parashihet indeksimi i pensioneve dhe ndihmës sociale, dhe kjo pritet të ngrit shpenzimet për këto dy vendime edhe për 20 milion € në vit. Ligji për Policinë do të kërkojë 10 milion € shtesë për implementim. Në prill të këtij viti Qeveria e Kosovës ka dërguar në Kuvend Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemat e Ndihmës Sociale. Ky ligj është dërguar në Kuvend përkundër kundërshtimit të MEF se hyrja në fuqi e këtij ligji ka një kosto financiare shtesë prej 3.3 milion €. Gjitha këto veprime kanë rrezikuar qëndrueshmërinë buxhetore. Në anën tjetër nuk ka shenja të rritjes së të hyrave buxhetore, të cilat pastaj do të mund të mbështesnin këto vendimet për rritjen e pagave. Hapa e ndërmarrë në PVPE kanë dëshmuar në kundërtën: vendimi për të rritur pagat, pensionet dhe ndihmat sociale ka rrezikuar qëndrueshmërinë financiare publike. Kjo konstatohet edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012.
  - Kërkesë tjetër e Partneritetit Evropian 2008 për Kosovën është edhe rritja e inkasimit të shërbimeve publike. Edhe pas një viti të publikimit të Partneritetit për Kosovën, inkasimi i shërbimeve publike ende mbetet në nivel të ulët. Një përmirësim në inkasim është raportuar nga KEK, ku gjatë vitit 2008 është raportuar rritje e të hyrave prej 18.26% në krahasim me vitin 2007. Duke marrë parasysh se gjatë vitit 2007 dhe viteve të mëhershme inkasimi ka qenë në gjendje shumë të ulët, rritja prej 18.26% nuk është ndonjë shifër që mund të ndikoj në qëndrueshmërinë financiare të KEK. Kjo pasi që edhe gjatë vitit 2009, por edhe në vitet 2010 dhe 2011 parashihen subvencione për KEK-un
  - Inkasimi i shërbimeve tjera publike nuk ka treguar shenja të përmirësimit. Sipas Raportit Vjetor për 2007 të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, të gjitha kompanitë rajonale të ujit kanë pasur probleme me faturim, edhe pse vërehet një përmirësim i lehtë.

Autoritetet duhet të monitorojnë kompletimin e masave nga plani i veprimit që të shihet nëse arritjet e tyre e kanë afruar Kosovën më afër drejt përmbushjes së kriterëve. Analizat e masave duhet të përshijnë vlerësimin e ndikimit që secila masë ka pasur.

*Koordinimi në mes institucioneve publike është në nivel të ulët*

Siç e pamë edhe nga shtjellimet e mësipërme, institucionet publike të Kosovës kanë hartuar plane të cilat adresojnë sfidat që dalin nga Partneriteti Evropian për Kosovën dhe Raporti i Progresit për Kosovën. Kriteret Ekonomike të Kopenhagës përfshijnë një fushë më të gjerë se ajo çfarë është paraqitur në Partneritetin Evropian dhe Raportet e Progresit. Komunikimi në mes ekzekutivit dhe legjislativit nuk është i mirë sa i përket adresimit të sfidave të paraqitura në raportin e Komisionit Evropian. Përderisa ekzekutivi është duke punuar me agjendën e PVPE, legjislativi ka një plan tjetër me të cilin synon të zgjidh sfidat e paraqitura në Raportin e Progresit 2008. Raporti i Progresit i 2008 për herë të parë ka arritur të mobilizoj Kuvendin e Kosovës që seriozisht të shqyrtoj problemet që përsëriten në Raportet e Progresit për disa vite radhazi. Kjo iniciativë e legjislativit nuk është pritur mirë nga ana e Qeverisë. Qeveria i ka kërkuar legjislativit që si agjendë të saj sa i përket sfidave të integritimit në BE të ketë Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian dhe jo një plan tjetër të veçantë.

*Debati në këtë fushë është i kufizuar dhe sipërfaqësor*

Mesazhi që na përsëritet vazhdimisht nga skena politike kosovare është se Kosova është në rrugë të mirë drejt integritimeve Euro-Atlantike dhe se institucionet e Kosovës janë duke miratuar ligje të cilat janë kompatible me standardet evropiane. Integritimi në BE nënkupton më shumë se sa vetëm miratim të legjislacionit. Integritimi në BE kërkon diskutime rreth politikave më të gjera dhe implementim të politikave. Me qëllim që kjo të arrihet, nevojitet që diskutimet rreth këtyre politikave të zgjerohen dhe të përfshijnë edhe ekspertizë të jashtme. Kosova ka kapacitete e duhura, si brenda ashtu edhe jashtë institucioneve, për të përmirësuar dhe pasuruar diskutimet për kriteret dhe standardet e BE. Këto kapacitete nuk janë shfrytëzuar në masë të duhur.

## **Rekomandimet**

*Përmirësimi i analizave, përmirësimi i lidhjeve në mes aktiviteteve/politikave dhe kriterëve*

Ekziston hapësirë e mjaftueshme për përmirësimin e dialogut në mes Kosovës dhe Komisionit Evropian – në kontest të Kriterëve Ekonomike të Kopenhagës. Pa dyshim në dispozicion kemi më shumë informata dhe të dhëna, se sa që jemi duke i shfrytëzuar aktualisht në këtë proces. Ky proces nuk mund të shikohet në kontest të kufizuar vetëm në drejtim të aksioneve specifike dhe realizueshmërisë së tyre. Raportet e Progresit kanë treguar se Kosova ka arritur progres të ulët sa i përket përmbushjes së aktiviteteve të parapara në PVPE. Nga kjo mund të konkludojmë se kërkohet më shumë analizë e cila merr në konsideratë Raportet e Progresit, Politikat e Qeverisë, Partneritetin Evropian dhe Kriteret e Kopenhagës. Nevojiten lidhje më konkrete në mes aktiviteteve të Qeverisë dhe rezultateve të kërkuara, realizimi i të cilave na sjell më afër integritimit në BE. Me

rastin e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), nevojitet që Qeveria të bëjë analizat e duhura të cilat tregojnë se politikat e parapara me KASH janë konsistente, janë të zbatueshme në aspekt afatgjatë dhe se buxheti nuk mund ti nënshtrohet ndryshimeve si pasojë e presioneve ad-hoc. Nëse analizat tregojnë se efektet nuk janë ato të cilat janë pritur dhe nuk na kanë sjell më afër plotësimit të standardeve, atëherë aktivitete duhet të rishqyrtohen dhe të zëvendësohen me aktivitete më konkretet dhe më me ndikim në plotësimin e standardeve. PVPE duhet që të jetë më fleksibile sa i përket ndryshimeve të vazhdueshme të gjendjes në terren dhe të mos mbetet vetëm si një plan i ngurtë pa u rishqyrtuar dhe analizuar.

Çelësi i zgjidhjes së problemeve qëndron në analizat e bëra dhe aksionet e ndërmarra në Planet e Veprimit. Nëse Kosova është e përkushtuar për integrim në BE, nevojiten reforma rrënjësore për tu përmbushur. Plani i Veprimit duhet që të reflektoj këto reforma rrënjësore dhe të vështira.

*Zgjerimi i debatit, përfshirja e akterëve kyç dhe përmirësimi politikave*

Kosova duhet të shfrytëzoj të gjitha kapacitete e saj në këtë proces. Gjithsecili ka një rol të veçantë për të përmbushur, duke përfshirë akterët politik në Qeveri dhe opozitë, në Kuvend dhe shoqëri civile. Të gjithë këta akterë kanë një qëllim të përbashkët dhe ky është procesi i integritit në BE.

Me qëllim që të arrihet sa më parë integrimi evropian, standardet e BE duhet të shndërrohen në diskutime dhe politika ditore. Kjo mund të bëhet vetëm nëse diskutimet zgjerohen dhe përfshijnë akterë të ndryshëm të cilët mund të japin kontribut të çmueshëm në këtë proces. Është koha që të tejkalojmë fazën e diskutime boshe për procesin e integritit, pa diskutuar politikat konkrete.

Shembuj se si të zgjerohet ky dialog dhe të bëhet më gjithëpërfshirës, dhe për përmirësimin e dialogut të brendshëm institucional, mund të gjenden në vendet e rajonit, siç është Kroacia dhe Maqedonia, të cilat kanë avancuar më shumë në procesin e integritit në BE, falë edhe zgjerimit të diskutimeve dhe gjithëpërfshirjes.

## Annex 1:


### KOSOVA NË KRAHASIM ME VENDET E TJERA, SA I PËRKET GJENDJES EKONOMIKE

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë marrëdhënie kontraktuale në shkallë të ndryshme me Bashkimin Evropian. Disa nga to janë në prag të anëtarësimit, disa kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, disa vetëm se kanë marrë statusin e vendit kandidat. Kosova nuk e ka asnjërën nga këto. Për shkak të statusit të pazgjidhur deri më 17 shkurt 2008, Kosova nuk ka pasur mundësi të nënshkruaj Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Pas shpalljes së pavarësisë e deri më tani, një nga problemet më të mëdha në marrëdhëniet UE-Kosovë mbetet mosnjohja e shtetit të Kosovës nga ana e pesë shteteve anëtare të UE: Spanjës, Sllovakisë, Qipros, Greqisë dhe Rumanisë.

Përveç që Kosova nuk ka marrëdhënie kontraktuale me UE, ashtu siç kanë vendet tjera të rajonit, Kosova ndodhet mbrapa këtyre vendeve edhe sa i përket përmbushjes së kriterëve për anëtarësim.

Më poshtë gjeni disa krahasime të asaj se ku ndodhet Kosova në krahasim me vendet e rajonit dhe ato të UE sa i përket indeksit të çmimeve, rritjes së GDP, inflacionit, papunësisë, etj.

Tabela e Indeksit IÇK për 27 Vendet e BE-së dhe Vendeve të Ballkanit



No.	Country	CPI Index (2008)
1	Macedonia	100.2
2	Bulgaria	100.6
3	Albania	102.2
4	Cyprus	102.3
5	Netherlands	105.5
6	France	106.1
7	Germany	106.6
8	Denmark	107.2
9	Sweden	107.2
10	Austria	107.3
11	Italy	107.4
12	Montenegro	107.4
13	United Kingdom	108.0
14	Malta	108.1
15	Poland	108.1
16	Belgium	108.3
17	Finland	108.3
18	Portugal	108.3
19	Luxembourg	108.6
20	Greece	110.6
21	Spain	110.7
22	Slovenia	112.2
23	Czech Republic	112.3
24	Slovakia	112.3
25	Kosovo	112.4
26	Ireland	113.5
27	Croatia	115.2
28	Bosnia & Herzegovina	116.1
29	Hungary	119.0
30	Romania	120.5
31	Estonia	122.9
32	Lithuania	124.5
33	Latvia	135.4
34	Serbia	137.1
35	Turkey	154.7
	EU 27 average	111.2


Burimi: Të dhënat statistikore nga EUROSTAT

Kriza aktuale financiare ka shkaktuar një masë serioze shqetësimi në ekonominë globale, i cila është i dukshëm në indikatorët e fundit ekonomikë të dhënë nga vende të ndryshme. Një nga efektet e kësaj krize është edhe ndikimi i saj në *Indeksin e Çmimeve të Konsumit* në të gjithë botën. Bazuar në analizën tonë mbi 27 vendet e BE-së, dhe vendeve të regjionit të Ballkanit si: Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Turqia; kemi vërejtur ndryshime domethënëse lidhur me shkallën e inflacionit. Analiza jonë nxjerr që në fund të vitit 2008, Bullgaria ka pasur shkallën më të ulët të inflacionit me 100.6 brenda 27 vendeve të BE-së, gjersa Latvia ka kryesuar në tabelë me IÇK Indeks me 135.4.

Nga rajoni i Ballkanit, Maqedonia ka pasur shkallën më të ulët të inflacionit me një Indeks IÇK prej 100.2, ndërsa Serbia ka kryesuar listën si vend me shkallën më të lartë të inflacionit prej 137.1 përkatësisht 154.7. Kosova ka shënuar një Indeks IÇK prej 112.4 në

vitin 2008, e cila vë në pah një nivel të moderuar të inflacionit, vetëm pak më të lartë se mesatarja e 27 vendeve të BE-së me 111.2.

**Tabela e përqindjes (%) së Shkallës së Papunësisë për 27 Vende të BE-së dhe Vendeve të Ballkanit**





No.	Country	Unemployment Rate % (2008)
1	Netherlands	2.7
2	Slovenia	4.1
3	Austria	4.2
4	Cyprus	4.3
5	Denmark	4.3
6	Czech Republic	4.7
7	Bulgaria	5.3
8	Luxembourg	5.5
9	Finland	5.8
10	Romania	5.8
11	Malta	6.0
12	United Kingdom	6.5
13	Italy	6.9
14	Belgium	6.9
15	Sweden	7.0
16	Poland	7.0
17	Germany	7.2
18	Greece	7.8
19	Portugal	8.0
20	Croatia	8.1
21	France	8.3
22	Hungary	8.3
23	Estonia	8.4
24	Ireland	8.7
25	Slovakia	9.3
26	Lithuania	9.7
27	Turkey	10.6
28	Latvia	11.5
29	Albania	13.5
30	Spain	14.7
31	Montenegro	14.7
32	Serbia	18.0
33	Bosnia	23.4
34	Macedonia	33.5
35	Kosovo	43.6
36	EU27 Countries	7.6


\*Burimi: Të dhënat statistikore nga EUROSTAT

Një aspekt tjetër i hulumtimit tonë ka qenë analizimi krahasues i shkallës së papunësisë në mes të 27 Vendeve të BE-së dhe vendeve të Ballkanit. Shkalla e papunësisë është një nga indikatorët më të rëndësishëm për të vështruar kur të analizohet ekonomia e një vendi të caktuar. Kriza ekonomike globale ka pasur efekt shkatërrues kur marrim parasysh papunësinë, sepse shumë kompani ishin të detyruara të pezullojnë punëtorët e tyre për të reduktuar koston dhe për të mënjanuar bankrotimin eventual.



Holanda ka shënuar shkallën më të ulët të papunësisë me 2.7% brenda BE 27, gjersa Spanja ka pasur një vit problematik me shkallën e papunësisë deri në 14.7%. Gjersa nga vendet e Ballkanit, Kosova prinë tabelën me 43.6% të shkallës së papunësisë, e përcjellur nga vendet tjera të Ballkanit që kanë pësuar rritje në shkallën e papunësisë. Është e rëndësishme të përmendet se të gjitha vendet e Ballkanit kanë shënuar një rritje domethënëse të shkallës së papunësisë në 2008 krahasuar me mesataren prej 7.6% të BE-së. Ky është një faktor veçanërisht shqetësues për vendet candidate dhe candidate potenciale siç janë Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria.

**Tabela Krahasuese për Rritjen Reale të GDP-së (%) në për vendet e BE 27 dhe të Ballkanit**



Real GDP Growth (%)			
No.	Country	2007	2008
1	Latvia	10	-4.6
2	Estonia	6.3	-3.6
3	Ireland	6	-2.3
4	Denmark	1.6	-1.1
5	Italy	1.6	-1
6	Luxembourg	5.2	-0.9
7	Sweden	2.6	-0.2
8	Portugal	1.9	0
9	France	2.3	0.4
10	Hungary	1.2	0.5
11	United Kingdom	3	0.7
12	Finland	4.2	0.9
13	Belgium	2.8	1.1
14	Turkey	4.5	1.1
15	Spain	3.7	1.2
16	Germany	2.5	1.3
17	Austria	3.1	1.8
18	Netherlands	3.5	2.1
19	Croatia	5.5	2.4
20	Malta	3.9	2.7
21	Greece	4	2.9
22	Lithuania	8.9	3
23	Czech Republic	6	3.2
24	Slovenia	6.8	3.5
25	Cyprus	4.4	3.7
26	Poland	6.6	5
27	Macedonia	5.9	5
28	Serbia	6.9	5.4
29	Kosovo	3.9	5.4
30	Bosnia	6.8	5.5
31	Bulgaria	6.2	6
32	Slovakia	10.4	6.4
33	Albania	6.3	6.8
34	Romania	6.2	7.1
35	Montenegro	10.7	7.6
36	EU27 Countries	2.9	0.9

\*Burimi: Të dhënat statistikore nga EUROSTAT

Sa i përket Rritjes Reale të GDP-së gjatë vitit 2008, shumica e vendeve në BE dhe rajonin e Ballkanit kanë vuajtur si rezultat i krizës financiare globale dhe ndikimit të saj në ekonomi. Bazuar në të dhënat zyrtare nga EUROSTAT dhe të dhënat zyrtare nga burimet e vendeve përkatëse, ne kemi parë se ka pasur një rënie domethënëse në rritjen reale të GDP-së në shumicën e vendeve të BE-së. Latvia ka pasur një rritje negative të GDP-së prej -4.7% gjatë vitit 2008, duke shënuar kështu rënien më të madhe nga 27 Vende të BE-së.

Vendet e Ballkanit çuditërisht kanë pasur një rritje stabile të GDP-së gjatë vitit 2008, meqë shumica e tyre kanë shënuar rritje më të madhe sesa mesatarja e GDP-së. Mali i Zi ka kryesuar me rritje të GDP-së prej 7.1%, gjersa Kosova ka pasur një rritje stabile të GDP-së prej 5.4% në 2008, nga një rritje prej 3.9% të GDP-së në 2007. Rritja relativisht stabile e GDP-së së vendeve të Ballkanit në përgjithësi i atribuohet faktit që këto vende kanë ekonomi më të izoluar dhe prandaj nuk janë prekur rëndë nga kriza financiare globale sikurse vendet tjera të zhvilluara të BE-së.

**Tabela e Krahasimit të Tregtisë së Jashtme për vendet e BE 27 dhe të Ballkanit**

Tregtia e Jashtme me Vendet e BE-së (*000)					
VENDI	IMPORT me BE	Pjesa e Importit Total	EKSPORT me BE	Pjesa e Eksportit Total	Balanci Tregtar i vendeve
Kosova	657,855	35.86%	91,225	49.62%	€ (1,623,410,000.00)
Shqipëria	1,923,390	62.80%	651,410	83%	€ (3,273,370,000.00)
Mali i Zi	827,286	35.69%	426,950	71.06%	€ (1,716,959,000.00)
Serbia	7,199,874	49.62%	3,481,464	50.44%	€ (7,608,078,000.00)
Maqedonia	2,576,037	48.10%	1,850,883	59.50%	€ (2,035,891,644.00)
Kroacia	13,078,950	64.75%	5,823,554	60.25%	€ (10,532,758,000.00)
Bosnja	2,353,172	40.44%	1,246,184	52.34%	€ (2,949,195,000.00)
Turqia	58,494,351	37%	49,562,391	48%	€ (54,736,090,000.00)

\*Për USD=EUR këmbimet, shkalla e këmbimit në këtë tabelë është 0.782




Tabela dhe grafi i mësipërm tregojnë statistikën e tregtisë së jashtme në mes të vendeve të Ballkanit dhe të BE-së. Analiza jonë ka treguar se BE-ja është partneri më i madh tregtar i Shqipërisë, meqë pjesa më e madhe e importeve dhe eksporteve të Shqipërisë me vendet e BE-së është 62% , përkatësisht 82%. Kosova në anën tjetër ndan 35.86% të importit total dhe 49.62% të eksportit total me vendet e BE-së. Është e rëndësishme të theksohet fakti që BE është partneri më i madh tregtar për të gjitha vendet e Ballkanit, megjithëse në 2009, ne parashohim një rënie të lehtë në tregtinë e jashtme me BE-në si rezultat i krizës financiare globale dhe trendeve aktuale të tregtisë globale. Një indikator shqetësues për të gjitha vendet e Ballkanit është deficitin e tyre tregtar. Të gjitha këto vende kanë një deficit të madh tregtar me Turqinë duke shënuar balancin më të madh deficitar prej 54.7 miliardë, gjersa Kosova me 1.6 miliardë ka shënuar deficitin më të ulët tregtar në rajon.